



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim dhe Intepretim B-A-B

Ngarkesa: 6kredite;15 leksione, 45 seminare;60orë gjithsej
Viti / Semestri: Viti II , semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyruar
Programi i studimit: Master i Shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Ky kurs synon të sistemojë në mënyrë profesionale përvojat që studentët kanë përfituar gjatë studimeve të mëparshme, ose në praktike të rastësishme. Ata do të pajisen me mekanizmat e nevojshëm logjikë e teknikë në kombinimet gjuhësore B-A. Përmes orientimit teorik dhe praktik studentët do të përmirësojnë aftësitë e tyre në fushën e përkthimit dhe interpretimit. Sigurisht që lënda do ndihmojë edhe në rritjen dhe përmirësimin e njohurive gjuhësore, por njëkohësisht edhe në zgjerimin e formimit të tyre të përgjithshëm.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të:

- 1.rifreskojë dhe zhvillojë njohuritë mbi turizmin;
- 2.krijojë aftësitë teorike dhe praktike specifike për përkthimin dhe interpretimin;
- 3.zotërojë përdorimin e teknologjisë në funksion të përkthimit e interpretimit.

Rezultate të pritshme:

Në përfundim të lëndës studenti do të jetë i aftë:

- 1.Të përkthejë me shkrim tekste nga fusha e turizmit si: katalogë, broshura, fletëpalosje, ture, përshkrime, faqe WEB etj. dhe të interpretojë(përkthejë me gojë) ligjërata nga fusha e turizmit, si: reportazhe, voice overs, konferenca shtypi etj.
- 2.Të mendojë në mënyrë kritike mbi zbatimin e teorisë në praktikë, si në përkthimit dhenë interpretim.
- 3.Të kërkojë për gjetjen dhe përdorimin e terminologjisë së duhur duke përdorur edhe tekste paralele.